



Funded by
the European Union



Mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave

Dhuna në familje nënkupton çdo akt dhune fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodh brenda familjes apo shtëpisë, nga partneri aktual ose ish-partneri, pavarësisht nëse jeton apo ka jetuar me viktimën. Qëllimi i saj është cenimi i dinjitetit dhe mbajtja e viktimës nën kontroll ose varësi.

Dhuna ndaj grave nënkupton çdo formë dhune me bazë gjinore që shkel të drejtat e grave dhe përbën diskriminim ndaj tyre. Ajo mund të shkaktojë dëm fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik, si dhe vuajtje, duke përfshirë kërcënimet, detyrimin ose privimin e padrejtë nga liria, si në jetën publike ashtu edhe në atë private.

Nëse përjetoni dhunë, institucionet në vijim janë në shërbimin tuaj për të ofruar ndihmë.

Policia e Kosovës

Ju mund ta raportoni rastin duke **telefonuar në numrin 192** ose duke shkuar personalisht në stacionin më të afërt të policisë.

Më pas, policia fillon reagimin, i cili varësisht nga rasti mund të përfshijë masa si ofrimin e sigurisë për ju dhe vartësit tuaj, largimin e kryesit nga vendi i ngjarjes, informimin tuaj mbi të drejtat tuaja ligjore dhe shërbimet ekzistuese, koordinimin dhe njoftimin e institucioneve të tjera relevante me pëlqimin tuaj, dhe sigurimin e transportit për ju dhe vartësit tuaj drejt qendrave mjekësore ose vendstrehimeve. Nëse rasti lajmërohet jashtë orarit të punës së gjykatës, policia mund të lëshojë urdhër për mbrojtje të përkohshme emergjente.

Prokuroria

Pas pranimit të dosjes nga policia, prokurorët janë përgjegjës për mbledhjen e dëshmive dhe ndjekjen penale të kryerësit edhe në rast se ju vendosni të mos bëni ndjekje penale.

Mbrojtësit e Viktimave

Mbrojtësit e Viktimave ju informojnë për të drejtat tuaja, duke përfshirë të drejtën për kompensim, si dhe për procedurat që duhet ndjekur. Me pëlqimin tuaj, ata ju ndihmojnë në hartimin e kërkesës për urdhër mbrojtjeje, në paraqitjen e saj në gjykatë dhe ju përfaqësojnë në të gjitha seancat gjyqësore lidhur me këtë kërkesë.

Ju mund të kontaktoni Mbrojtësit e Viktimave në **numrin e telefonit pa pagesë 0800 11112** për të marrë informata dhe për tu referuar për shërbimet ekzistuese në dispozicion për rastin tuaj.

Ju po ashtu mund të kontaktoni **zyren e Mbrojtësit e Viktimave në Prishtinë** duke telefonuar **044 278 738**.

Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale ju mbështet në qasjen e shërbimeve të ndryshme duke përfshirë strehimin, asistencën sociale, riintegrimin, punësimin, këshillimin psikosocial, pjesëmarrjen në seanca gjyqësore dhe të tjera. Ju do të keni një menaxher/e të rastit që ju ndihmon dhe koordinon shërbimet e nevojshme.

Ju mund të kontaktoni Qendrën për Punë Sociale në Prishtinë përmes numrit të telefonit QPS-

Njësia Qafa 038 243107 dhe 038 220955

Njësia Kodra e diellit – 038 220364

Njësia Kodra e trimave 038 611071

Strehimoret

Strehimoret janë organizata joqeveritare të licencuara për të ofruar mbrojtje dhe kujdes për ju dhe vartësit tuaj. Roli i tyre kryesor është rehabilitimi dhe riintegrimi juaj në shoqëri. Disa nga shërbimet e specializuara që ofrojnë strehimoret përfshijnë kujdes shëndetësor, këshillim psikologjik dhe këshillim juridik.

Ju mund të kontaktoni **strehimoren OJQ Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Femijeve në Prishtinë** duke telefonuar **038 545 476** apo **044 425 111**.

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është institucioni i vetëm në Kosovë, përgjegjës për ofrimin dhe organizimin e ndihmës juridike falas.

Ju mund të kontaktoni Zyrën Rajonale për Ndihmë Juridike Falas në Prishtinë përmes numrit të telefonit **038 200 18 941**.

Mekanizmat Koordinues Lokal

Mekanizmat Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore kanë për detyrë koordinimin ndër-institucional në nivel lokal me qëllim të mbrojtjes dhe mbështetjes tuaj.

Gjykatat

Gjykatat e trajtojnë rastin tuaj përmes procedurave civile dhe penale. Në procedurat civile, ato shqyrtojnë kërkesat për urdhër mbrojtjeje, ndërsa në procedurat penale marrin vendime në rastet kur zhvillohet ndjekja penale ndaj kryerësve të dhunës ose ndaj atyre që kanë shkelur urdhrat e mbrojtjes.

Shërbime të tjera

Qeveria e Kosovës ka miratuar një masë që subvencionon 70% të pagës bruto (deri në 300 euro) për viktimat e dhunës, për një periudhë deri në 6 muaj, me qëllim nxitjen e pavarësisë së tyre financiare. Për të aplikuar për këtë masë, duhet të telefononi në **numrin pa pagesë 0800 10010** në Ministrinë e Drejtësisë, ku do të udhëzoheni për mënyrën e regjistrimit dhe për hapat e mëtejshëm.

Komuna e Prishtinës ofron mbështetje përmes ofrit të mundësive për strehim për viktimat e dhunës.